

PERCEP

MADAMEYEVONDE ALIJEVOKSHI CLARESTRAND RACHELWHITEREAD LAURAAALDRIDGE

TIONSBU

ANTHEAHAMILTON CAMILLALOW ALKETAXHAFAMRIPA TRACEYEMIN RUDINAXHAFERI

RRRNESH

HELENCHADWICK ZAKEPRELVUKAJ ABIGAILLANE ARBANAHAJREDINAJ GILLIANWEARING

ATPERC

SARAHLUCAS CELIAHEMPTON HAVEIT FLAKAHALITI ELIZABETHPRICE LUBAINAHIMID

EPTIME

PËRMBAJTJE/ CONTENTS

Parathënie / Foreword Ema Dexter	8
Perceptime / Perceptions Ana Bogdanovic	12
Perceptions.Kosovë: Burrneshat / Perceptions.Kosovo: Burrneshat Arta Agani	26
Biografitë e artisteve / Biographies of artists	62
Autorësia dhe mirënjohjet / Credits and Acknowledgments	116

PARATHËNIE

Emma Dexter

Kjo ekspozitë është njëra nga pesë ekspozitat që do të shfaqen në Ballkanin Perëndimor nën titullin e përbashkët, Perceptimet (Perceptions), duke paraqitur 24 vepra nga 14 artistë të gjinisë femërore nga koleksioni i Këshillit Britanik (British Council), të punuara së bashku me efekte të kundërta si dhe me një përzgjedhje të veprave të artistëve vendor, për ta bërë çdo prezantim të përshtatur dhe të veçantë.

Perceptimet janë rezultat i bisedimeve në mes të pesë institucioneve tona partnere në Ballkanin Perëndimor, të cilët ofruan idetë dhe temat kryesore të projektit. Kjo ka inkurajuar bashkëpunimin në mes të partnerëve rajonalë, të cilët kanë kuruar ekspozita të reja nga Koleksioni i Këshillit Britanik, i cili do ta joshë publikun e tyre dhe do të hapë një dialog rreth mbledhjes së politikave.

Partnerët tanë u frymëzuan nga sukcesi i ekspozitave të fundit të Këshillit Britanik në rajon siç janë, Henry Moore, The Printmaker në 2014, Feja e Re nga Damien Hirst më 2015-16 dhe Kotësia e Dallimeve të Vogla nga Grayson Perry në vitin 2017, që dëshmuuan se kishte një audiencë të etur për artin bashkëkohor në Ballkanin Perëndimor. Me Perceptimet, muzetë tona partnere kanë rastin që të përqendrohen në gratë artiste në Koleksionin e Këshillit Britanik dhe të shfaqin punën e artisteve nga rajoni. Programi ka nxitur një dëshirë për të korigjuar balancën gjinore në kuadër të programeve të ekspozitave të institucioneve partnere dhe ka nisur një dialog brenda Ballkanit Perëndimor rreth politikave për mbledhjen e dëshmive.

Çdo prezantim shpreson të sfidojë mungesën (padukshmërinë) e grave artiste në rajon dhe perceptimin se nuk ka artiste të mëdha femra që kanë vepruar ose veprojnë në rajon, që është një debat aktual brenda botës së artit, përgjithësisht si në rajon po ashtu edhe në nivel ndërkombëtar.

Falënderojmë pesë institucionet partnere: Muzeun Kombëtar të Malit të Zi, Galerinë e Maticës Serbe, Galerinë Kombëtare të Prishtinës, Muzeun e Arteve Bashkëkohore të

Republikës Serbe, Muzeun e Arteve Bashkëkohore në Shkup dhe Natalija Vujošević, Jelena Ognjanović, Arta Bunjaku Agani, Lana Pilipović dhe Blagoja Varošaneć të cilat kanë bashkëpunuar me pasion dhe vizion të madh në këtë projekt ambicioz, duke e udhëhequr këtë projekt të rëndësishëm dhe duke shfaqur metoda të reja, që e kanë përshtatur ekspozimin e tyre në vend me aftësi dhe ndjeshmëri. Pa entuziazmin, punën e madhe dhe angazhimin e tyre në këtë projekt ambicioz, kjo ekspozitë nuk do të ishte e mundur.

FOREWORD

Emma Dexter

This exhibition is one of a series of five which will be shown within the Western Balkans under the collective title, *Perceptions*, presenting 24 works by 14 female artists from the British Council Collection, juxtaposed at each institution with a selection of works by local artists, to make each presentation unique and bespoke.

Perceptions is the result of conversations between our five partner institutions in the Western Balkans, who provided the key ideas and themes which informed the project brief. This has encouraged collaborative working between the regional partners, who have curated new exhibitions from the British Council Collection, which would appeal to their audiences and open a dialogue around collecting policy.

Our partners were inspired by the success of recent British Council Collection exhibitions in the region, Henry Moore, *The Printmaker* in 2014, Damien Hirst's *New Religion* in 2015-16 and Grayson Perry's *Vanity of Small Differences* in 2017, which proved there was a keen audience for contemporary art in the Western Balkans. With *Perceptions* our partner museums have taken the opportunity to focus on women artists in the British Council Collection and to showcase the work of women artists from the region. The programme has stimulated a desire to redress the gender balance within each partner institutions' exhibition programmes and has started a dialogue within the Western Balkans around collecting policies.

Each presentation hopes to challenge the relative invisibility of women artists in the region, and the perception that there are no great female artists, historically or currently working in the region, which is a timely debate within the art world generally both regionally and internationally.

We would like to thank our five partner institutions: National Museum of Montenegro, Gallery of Matica srpska, National Gallery in Priština, Museum of Contemporary Arts of Republic of Srpska, Museum of Contemporary Arts Skopje and Natalija Vujošević, Jelena Ognjanović, Arta Bun-

jaku Agani, Lana Pilipović and Blagoja Varošaneć who have worked collaboratively with great passion and vision on this ambitious project, steering the brief to make this project relevant and innovative for today, and tailoring their own exhibition to their venue with skill and sensitivity. Without their enthusiasm, hard work and engagement this ambitious exhibition project would not have been possible.

PERCEPTIMET

Ana Bogdanović

Pse nuk ka pasur gra artiste të mëdha? është pyetja që bëri Linda Nochlin në vitin 1971, duke hapur një sërë çështjesh që kanë të bëjnë me historitë e artit që kanë lënë anash, kanë marginalizuar dhe injoruar zërat dhe pozitat e grave brenda botës së artit. Çështjet janë ende të pazgjidhura, dhe megjithëse pyetja u ngrit rreth gjysmë shekulli më herët, ajo ende diskutohet në nivel global, jo vetëm në mes të artistëve, por edhe në mesin e qarqeve më të gjëra shoqërore.

Përkundër ndërrimeve të mëdha në emancipimin e grave dhe luftën për barazi që është arritur gjatë njëqind viteve të fundit, shoqëria bashkëkohore ka përcaktuar vazhdimisht norma të marrëdhënieve shoqërore dhe politike patriarkale që mbajnë gratë në pozita të pabarabarta ekonomike, arsimore dhe kulturore. Kjo natyrisht, po pasqyrohet në praktikën bashkëkohore artistike dhe të ekspozitave të cilat mbeten vazhdimisht të lidhura me të ashtuquajturat ‘Çështje të grave’. Prandaj nuk është aspak befasuese që ekspozita e parë e projektit Perceptimet (Perceptions), e cila u hap në Muzeun Kombëtar të Malit të Zi në Cetinje, u titullua “Pse nuk ka pasur artistë të mëdhenj meshkuj”? - duke theksuar domosdoshmërinë e rishqyrtimit të një prej provokimeve kyçe për të kuptuar jo vetëm artin, por edhe marrëdhëniet e kaluara dhe të tashme shoqërore brenda rajonit.

Projekti “Perceptimet” është zhvilluar përmes dialogut në mes të punimeve të artisteve të shquara Britanike nga koleksioni i Këshillit Britanik dhe veprave të artisteve të zgjedhura nga kuratorët në pesë institucionet bashkëpunuese muzeale ku do të mbahet ekspozita: Muzeu Kombëtar i Malit të Zi në Cetinje, Galeria e Matica Serbe në Novi Sad, Muzeun e Artit Bashkëkohor të Republikës Serbe në Banja Llukë, Galeria Kombëtare e Arteve në Prishtinë dhe Muzeun e Artit Bashkëkohor Maqedon në Shkup.

Pesë ekspozitat ballafaqohen me mënyra të ndryshme artistike për të rishikuar rolin e vet, përfaqësimin dhe statusin e grave përmes historisë moderne të artit dhe praktikave të artit bashkëkohor. Ato janë projektuar si komente në

trajektoren e situatave komplekse shoqërore dhe historike në hapësirën e ish Jugosllavisë, duke hapur një kapitull të rëndësishëm jo vetëm në aspektin e aktualizimit të statusit të grave brenda sistemeve artistike në nivelin lokal, por edhe në kontekstin e bashkëpunimit që është rivendosur në mes të arteve të lartpërmendura dhe qendrave muzeale.

Rrethanat në të cilat arti diskutohet në kontekstin shoqëror të Britanisë, Malit të Zi, Serbisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Kosovës dhe Maqedonisë, sigurisht ndryshojnë në shumë aspekte, por vlen të kujtojmë se këto ndryshime tejkalohen nga aspiratat e përbashkëta për imazhet, qëndrimet, dhe stereotipet rreth grave që duhet të mendohen në mënyrë kritike dhe të debatohen si çështje universale dhe të domosdoshme më të mëdha se çdo veçori lokale, megjithëse shpesh kushtëzohen pikërisht nga këto veçori.

Duke pasur parasysh kompleksitetin e jashtëzakonshëm të temës, qasja në bisedat e ekspozitave të konceptualizuara ka evoluar në disa drejtime, duke konfirmuar temën me shumë nivele dhe shumë aspekte, duke treguar në të njëjtën kohë diversitetin e metodologjive kuratoriale që ekzistojnë në institucionet e muzeve partnere.

Për shembull, duke zgjedhur gratë artiste, veprat e të cilave nuk janë pjesë e koleksionit të Muzeut Kombëtar të Malit të Zi, kuratorja Natalija Vujošević problematizon jo vetëm çështjet që lidhen me pozitat artistike të grave, por edhe mekanizmat e krijimit të koleksionit të muzeut, si dhe politikat institucionale, ndërsa Jelena Ognjanović nga Galeria e Matica Serbe zgjedh të bashkojë veprat mbizotëruese bashkëkohore të artisteve britanikë me shembuj të pikturave historike serbe dhe veprave moderniste të gjysmës së parë të shekullit të 20-të (të artistëve femra dhe meshkuj), dhe kështu e thekson vlerën historike të temës qendrore të projektit.

Në Muzeun e Artit Bashkëkohor të Republikës Serbe, kuratorja Lana Pilipović braktis kuadrin lokal të ngushtë dhe bashkon veprat e artisteve Britanike me artiste bashkëkohore

të gjeneratave të ndryshme që veprojnë në disa vende të rajonit, duke hartuar kështu ngjashmëritë tematike që shfaqen në kontekste të ndryshme shoqërore në lidhje me rolet dhe përfaqësimin gjinor.

Arta Agani nga Galeria Kombëtare e Arteve në Prishtinë zhvillon dialogun e ekspozitës së artit përmes matricave tematike konceptuale duke problematizuar fazat e ndryshme të pozicionimit të grave në rrethanat shoqërore që kanë për karakteristikë situatat Britanike dhe Kosovare, ndërsa Blagoja Varošanec nga Muzeu i Artit Bashkëkohor në Shkup zhvillon një bisedë mes artisteve Britanike dhe Maqedonase duke marrë një qasje ndër-kulturore dhe ndër-historike, duke theksuar perspektiva të reja. Tregimet e ekspozitës pasqyrojnë shumë më tepër sesa vetëm subjektet qendrore në lidhje me statusin dhe pozitën e grave në art dhe shoqëri. Ato inkurajojnë diskutime për çështje më të gjëra sociale dhe politike dhe në të njëjtën kohë kanë sukses në dekonstruktimin e modeleve të zhvillimit dhe grumbullimit, si dhe politikave të përgjithshme të institucioneve bashkëkohore të arteve të bukura në ripërcaktimin e potencialeve dhe kapaciteteve të bashkëpunimit rajonal.

Meqenëse tema e projektit tregon për rishqyrtimin e roleve të grave në mjedise më të gjëra sociale, ekonomike, mediale dhe kulturore, vëmendje e veçantë i kushtohet programeve shoqëruese të ekspozitës të cilat, duke përfshirë ekspertë dhe bashkëpunëtorë nga fusha të ndryshme, aktivizojnë gjithashtu bisedat artistike të bazuara në një shumëllojshmëri të përvojave dhe pikëpamjeve të ndryshme. Kjo kontribuon në një shqyrtim më të plotë dhe nëpërmjet shqyrtimit dhe kuptimit të një fenomeni lidhur me statusin dhe trajtimin e grave në rrethanat historike dhe bashkëkohore. Duke pasur parasysh qëllimin që hapësirën e të menduarit të institucioneve të muzeut të jenë të arritshme për vizitorët e shumtë dhe sa më të ndryshëm, krijimi i lidhjeve të reja brenda programeve të ekspozitës ka qenë një nga detyrat kryesore të këtij projekti. Duke pasur parasysh rëndësinë

bashkëkohore të temës, ky ishte një objektiv veçanërisht i rëndësishëm.

Duke këmbëngulur në rëndësinë e afrimit të temës së pozitës së gruas në kontekste të ndryshme, dhe duke i bërë këto çështje publike të dukshme dhe duke i diskutuar ato, nuk është vetëm përgjegjësi e institucioneve kulturore dhe individëve të përfshirë në botën e artit, por edhe të të gjithë pjesëmarrësve të tjerë të jetës publike dhe në proceset sociale të cilat krijojnë, drejtojnë ose ndikojnë në vlerat e ruajtura dhe të riprodhuara në shoqërinë bashkëkohore. Kjo është arsyeja pse ekspozitat “Perceptimet”, u krijuan dhe u realizuan si platforma dinamike dhe të hapura për reflektim kritik mbi artin dhe njohuritë e frymëzuara nga arti. Platformat do të shfaqen në qytetet e rajonit për të siguruar goditjen e nevojshme për krijimin e një debati më të gjerë publik dhe për të intensifikuar dialogun në rajon, i cili, duke ndarë një përvojë të përbashkët historike, ushqen specifikat lokale dhe ku pozicionet dhe rolet e grave paraqesin çështje jetësore në rrugën për horizonte të reja të ndryshimeve të ardhshme.

PERCEPTIONS

Ana Bogdanović

Why Have There Been No Great Women Artists? is the question which Linda Nochlin asked back in 1971, opening up a series of issues concerning art history canons that have been neglecting, marginalizing and ignoring women's voices and positions within the complex art world. The issues are still unresolved, and although the question was raised nearly half a century ago, it is still globally discussed, not only among artists but also among much broader social constellations. Despite major shifts in women's emancipation, and struggles for equality won over the past hundred years, the contemporary society has been repetitively producing norms of patriarchal social and political relations that keep women in unequal economic, educational and cultural positions. This, of course, is being reflected in contemporary artistic and exhibition practices which remain continuously concerned with the so-called 'women's issues'. It is therefore not at all surprising that the first exhibition of Perceptions project, which opened in the National Museum of Montenegro in Cetinje, was entitled Why Have There Been No Great (Wo)Men Artists? – pointing to the necessity of reconsidering one of the key provocations for understanding not only the art, but also past and present social relations within the region.

Project Perceptions has been developed through establishing dialogues between works of prominent British women artists from the British Council Collection and works of artists chosen by curators in five partnering museum institutions hosting the exhibitions: National Museum of Montenegro in Cetinje, The Gallery of Matica srpska in Novi Sad, Museum of Contemporary Art of Republika Srpska in Banja Luka, National Art Gallery in Priština, and Contemporary Art Museum of Macedonia in Skopje. The five exhibitions confront different artistic approaches to re-examination of the role, (self)representation and status of women through modern art history and contemporary art practices. They have been designed as commentaries in the trajectory of complex social and historical situations in the space of former Yugoslavia, opening

a significant chapter not only in terms of the renewed actualization of the women's status within the local artistic systems, but also in the context of the re-established cooperation between the aforementioned art and museum centres. The circumstances in which the art is discussed in the social contexts of Britain, Montenegro, Serbia, Bosnia and Herzegovina, Kosovo and Macedonia certainly differ in many respects, but it is worth remembering that these differences are surpassed by the common aspiration for images, attitudes, and stereotypes about women to be critically thought over, and debated as universal and indispensable issues greater than any local specificities – although often conditioned precisely by these very specificities.

Given the theme's extraordinary complexity, the approach to the conceptualized exhibits' conversations has evolved in several directions, confirming the multi-layered and multifaceted theme, while at the same time showing the diversity of curatorial methodologies existing in partner museum institutions. For instance, by selecting women artists whose works are not part of the National Museum of Montenegro's collection, its curator Natalija Vujošević problematizes not only issues related to women's artistic positions, but also the very mechanisms of creating the museum's collection, as well as institutional policies, while Jelena Ognjanović of the Gallery of Matica srpska chooses to juxtapose the predominantly contemporary works of British women artists with examples of Serbian historical paintings and modernist works of the first half of the 20th century (of both female and male artists), and thus emphasize the historical value of the project's central theme. In the Museum of Contemporary Art of Republika Srpska, its curator Lana Pilipović abandons the close-fitting local framework, and juxtaposes works of British women artists with contemporary women artists of several generations operating in several countries of the region, thus mapping thematic similarities appearing in different social contexts in relation to gender roles and representations.

Arta Agani of the National Art Gallery in Priština develops the art exhibit's dialogue through thematic conceptual matrices problematizing different phases of women's positioning in social circumstances characteristic of the British and Kosovo situations, while Blagoja Varošaneć of Museum of Contemporary Art in Skopje conducts a conversation between British and Macedonian women artists by taking a cross-cultural and cross-historical approach, highlighting new perspectives. Exhibition narratives thus reflect much more than solely the central subjects concerning the status and position of women in the art and society. They encourage discussions on wider social and political issues, and at the same time succeed in deconstructing models of collection development and general policies of contemporary fine art institutions, and in redefining potentials and capacities of regional cooperation.


Since the project's theme points to re-examination of women's roles in the wider social, economic, media and cultural environments, special attention is paid to accompanying exhibition programmes which, by involving experts and associates from different fields, additionally activate the artistic conversations based on a variety of experiences and different points of view. This contributes to a more thorough and through consideration and understanding of a phenomenon regarding the status and treatment of women in historical and contemporary circumstances. Given the aim to make the thinking space of the museum institutions accessible to as numerous and as diverse audiences as possible, creating new strands within the exhibition programmes has been one of the vital tasks of this project. In view of the theme's contemporary relevance, this was a particularly significant goal.

Insisting on the importance of bringing the topic of a woman's position in various contexts to the forefront, making these issues publicly visible and discussing them is not only a responsibility of cultural institutions and individuals involved in the art world, but also of all other participants in public life and in social processes which create, direct or influence the

values maintained and reproduced in contemporary society. That is why the Perceptions exhibitions were created and realized as dynamic and open platforms for critical reflection on art and art-inspired knowledge. The platforms will tour the cities of the region to provide the kick necessary for establishing a wider public debate, and to intensify dialogue within the region which, while sharing a common historical experience, nourishes local specificities, and where women's positions and roles represent vital issues on the road to new horizons of future change.

PERCEPTIONS
BURRNESHAT
PERCEPTIME

Prishtinë, 2019

This exhibition is named BURNESHAT (Burrë = man). The literal  translation that may be found in the dictionary would be “Sworn Virgins”, referring to certain women in Albania mountains that live a man’s life. However, this word has another meaning in Kosovo. The word is more or less used as a compliment for a woman that displays decisiveness, trustworthiness and strength the personality traits supposedly attributed to men. And they don’t shed tears. The title is an ironical comment towards discrimination of women that go as far as attributes, while in reality women are truly strong engines that move our society. Women artists in Kosovo were and still are to an extent, typical examples of gender discrimination. In Europe, though roughly two centuries ago, women were also left out of the cultural establishments and had to struggle their way into art schools, museums and galleries and gain notable credit. The first Kosovo woman graduated in an art school as late as the 70’s, in a time when creativity of women was still limited to embroidery and knitting. Now, women are art teachers, artists and employed in art institutions in a satisfactory rate towards equality

This exhibition is named Burrneshat(Burrë = man). The literal translation that may be found in the dictionary would be “Sworn Virgins”, referring to certain women in Albania mountains that live a man’s life. However, this word has another meaning in Kosovo. The word is more or less used as a compliment for a woman that displays decisiveness, trustworthiness and strength the personality traits supposedly attributed to men. And they don’t shed tears. The title is an ironical comment towards discrimination of women that go as far as attributes, while in reality women are truly strong engines that move our society. Women artists in Kosovo were and still are to an extent, typical examples of gender discrimination. In Europe, though roughly two centuries ago, women were also left out of the cultural establishments and had to struggle their way into art schools, museums and galleries and gain notable credit. The first Kosovo woman graduated in an art school as late as the 70’s, in a time when creativity of women was still limited to embroidery and knitting. Now, women are art teachers, artists and employed in art institutions in a satisfactory rate towards equality

Përceptimet, Kosovë: Burrneshat

Arta Agani,
kuratore e
ekspozitës
”Perceptimet”
për Kosovë dhe
drejtoreshë e
Galerisë
Kombëtare të
Kosovës

**16% e grave
në Kosovë
janë pronare
të regjistruara
të pasurive të
paluajtshme**

FAKTET

Pjesëmarrja e grave në vendimmarrje në Kosovë, si në numër, ashtu edhe në ndikimin aktual, ballafaqohet me pengesa të shumta për arsye të ndryshme. Mentaliteti dhe analfabetizmi konsiderohen si arsyet kryesore për kufizimin e rolit të gruas në vendimmarrje. Kjo situatë ka filluar të ndryshojë që nga viti 2000¹ me implementimin e kuotës prej 30% të ulëseve të rezervuara për gratë në Kuvendin e Kosovës dhe në Kuvendet Komunale.

Sipas të dhënave që i kemi deri tani, vetëm 16% e grave në Kosovë janë pronare të regjistruara të pasurive të paluajtshme².

Koleksioni i Galerisë Kombëtare të Kosovës është i vetmi koleksion i artit bashkëkohor në pronësi publike. Ai përbëhet nga 1000 vepra arti, që mbulojnë periudhën nga vitet 1960 deri më sot. 17 vepra që janë në këtë koleksion janë krijuara nga 10 gra: Alije Vokshi, Hyrije Krypa, Violeta Xhaferi, Zake Prelvukaj, Mimoza Veliu, Linda Vukaj-Ricommini, Blerta Sylja, Rudina Xhaferi, Afrora Blakcori Uka, Mina Krasniqi³.

Ka shumë fakte si këto, që përshkruajnë pozitën e grave në shoqërinë Kosovare. Bazuar në faktet e përmendura më lart, lirisht mund të sugjerojmë se situata në skenën e artit nuk është shumë më e keqe se në skenat tjera. Shoqëria Kosovare është shumë e veçantë: E banuar nga popuj që i përkasin religjioneve dhe kulturave të ndryshme, me shumicë e shqiptare; E rrethuar nga kultura dhe religjione të ndryshme, e megjithatë e ndikuar nga kultura perëndimore. E ndarë nga Shqipëria vetëm me një kufi, Kosova ka një histori të përbashkët me të gjithë fqinjët e tjerë të cilët kanë qenë të përfshirë në konfliktet e fundit në rajon. Gratë në Kosovë në përgjithësi nuk janë të suksesshme në karrierat e tyre -

1. Pjesëmarrja e femrave në vendimmarrje në Kosovë - EEAS - Europa BE https://eeas.europa.eu/sites/eeas/files/womens_participation_sq.pdf

2. “PROJEKTI PËR PATUNDSHMËRI DHE KADASTËR – Rekap. për kënaqshmërinë vjetore të klientëve - FAZA E DYTË <http://www.kca-ks.org/documents/10179/319567/ang.pdf/3f4bf6ff-7ba4-46ee-8d17-b0e0cb3d7a2d>

3. Regjistri i të dhënave të mbledhura nga Galeria Kombëtare e Kosovës

me disa përjashtime. Duke marrë parasysh rrethanat tipike në një shoqëri patriarkale siç është Kosova, familja është një institucion qendror i udhëhequr nga një figurë mashkullore. Kështu, shoqëria imponon shumë kërkesa për një grua ku ajo e vetme duhet të kujdeset për tërë familjen (e cila shpesh nuk është e vogël), të jetë përgjegjëse për rritjen e fëmijëve dhe në të njëjtën kohë të duket bukur. Një karrierë profesionale nuk është diçka që shoqëria jonë e pret nga një grua dhe në shumicën e rasteve varet prej gruas nëse ajo është e gatshme të bëjë një karrierë me gjithë punët tjera që priten nga ajo. Ato që e arrijnë këtë gjë, thjesht mund të konsiderohen heroína.

Megjithatë, gjërat po lëvizin shpejt në të mirë të grave kosovare. Historia e tyre ishte dhe mbetet shqetësim, dhe në këtë ngutësi për t'u bërë pjesë e diçkaje më të madhe, si Bashkësia Evropiane, shoqëria Kosovare mund të quhet me fat që i ka kapërcyer disa hapa të dhimbshëm në rrugën drejtë “emancipimit” të gruas. Deri tani procesi nuk ka zgjatur aq shumë. Kjo ka ndodhur pasi që Kosova është një vend i ri që ka lindur mes të një divorci dhe të gjitha proceset kanë ndodhur shumë shpejt.

EKSPOZITA

Kjo ekspozitë quhet Burrneshat (Burrë = man). Përkthimi i saktë nga fjala që mund të gjendet në fjalor do të ishte “Virgjëreshat e përbetuara”⁴, duke iu referuar disa grave në malet e Shqipërisë që jetojnë jetën si mashkuj. Megjithatë, kjo fjalë ka një kuptim tjetër në Kosovë. Kjo fjalë përdoret si një kompliment për një grua që ka vendosmërinë, be-

4. Në Shqipëri, një “virgjëreshë e përbetuar” është grua që ka zgjedhur të marrë identitetin shoqëror të një mashkulli në jetë. Është një traditë që daton me qindra vjet dhe ende ekziston në Alpet shqiptare, si dhe në një masë më të vogël në pjesët tjera të Ballkanit Perëndimor. Praktika u zhvillua nga kanuni, një përmbledhje patriarkale arkaike e ligjeve që filloi të përdoret kryesisht në Kosovën jugore dhe në Shqipërinë veriore në shekullin e 15-të. Ky kodeks i lashtë thotë se gratë, përveç virgjëreshave të betuara, janë pronë e burrave të tyre, gjë që ju mohon atyre disa nga të drejtat dhe liritë themelore, si të kenë të drejtë të kryejnë biznese, të fitojnë para, të pijnë duhan, të mbajnë një orë, ose të shajnë me zë të lartë (htt1)

**Gruaja e parë
kosovare
diplomoi në
një shkollë arti
në vitet e 70-ta**

sueshmërinë, fuqinë –tipare që me sa duket u atribuohen meshkujve. Madje, ato nuk derdhin lot.

Titulli është një koment ironik ndaj diskriminimit të grave që shkon aq larg, deri te atributet, ndërsa në realitet gratë janë motorët shumë të fortë që e mbajnë shoqërinë tonë në lëvizje. Artistet në Kosovë ishin dhe ende janë në një masë, shembuj tipikë të diskriminimit gjinor. Edhe në Evropë, para rreth dy shekujve, gratë ishin lënë jashtë institucioneve kulturore dhe duhej të luftonin për të hyrë në shkollat e artit, në muze dhe galeri dhe për tu vlerësuar. Gruaja e parë kosovare diplomoi në një shkollë arti në vitet e 70-ta, në një kohë kur kreativiteti i grave ishte ende i kufizuar në qëndisje dhe thurje. Tani, gratë janë mësimdhënëse të artit, artiste dhe të punonjëse të institucioneve të artit në një nivel të kënaqshëm drejt barazisë. Kështu që nëse e krahasojmë me vendet e rajonit, situata është pak a shumë e njëjtë: gratë artiste më në fund po vlerësohen me një ritëm shumë të vonuar, por me hap të vendosur. Megjithatë, sa më shumë që e shqyrtojmë këtë fenomen social, aq më shumë pyetje ngriten. Një pyetje që nuk mund të shmanget është: Pse ka kaq shumë mospërputhje në mes numrit të studenteve të artit dhe numrit të artisteve të diplomuara gra që janë aktive? Shifrat shënojnë një rënie drastike, derisa gratë artiste e gjejnë veten duke punuar punë të tjera dhe duke u marrë me familjet. Andaj, a është të qenit artiste grua punë shumë kërkuese?

Ekspozita “Burrneshat” vjen si rezultat i një bashkëpunimi dyvjeçar në mes të pesë kuratorëve dhe institucioneve me titull “Perceptimet”, një qasje vërtet unike dhe e pazakontë e iniciuar nga Këshilli Britanik dhe politikant e saj ndaj inovacionit në botën e artit. Sjellja e një pjese të koleksionit të Këshillit Britanik që është autorizuar nga artistet gra në pesë vendet e Ballkanit është një përfitim i jashtëzakonshëm për audiencën tonë. Sidoqoftë, ekzistojnë edhe aspekte tjera për Perceptimet që i shtojnë vlerën. Një bashkëpunim i çmuar në mes të pesë institucioneve të vendeve fqinje, që kanë lindur nga rrënojat e luftërave të Jugosllavisë dhe natyrisht, një mundësi unike për artistët lokalë të ekspozojnë krahas krahas me artistë të njohur botërorë Britanikë. Sa i përket kurimit të ekspozitës, ajo ishte një punë sfiduese, por në të njëjtën kohë profesionale dhe frymëzuese. Unë pres me padurim iniciativën e ardhshme që do të mbahet nga Këshilli Britanik, duke qenë e sigurt se do të jetë diçka kreative dhe inovative si kjo.

Koncepti i ekspozitës lidhet me teorinë e Oscar Wilde në “Dorian Grey” për bukurinë, duke njohur procesin e të menduarit si një armik të saj: “Por bukuria, bukuria e vërtetë përfundon aty ku fillon një shprehje intelektuale ”⁵.

Në këtë ekspozitë do të marrin pjesë 14 artiste nga Britania e Madhe si: Madame Yevonde, Clare Strand, Abigail Lane, Rachel Whiteread, Camilla Løw, Anthea Hamilton, Laura Aldridge, Helen Chadwick, Tracey Emin, Sarah Lucas, Gillian Wearing, Elisa Price, Celia Hempton dhe Lubaina Himid; në “bashkëbisedim” me shtatë artistet kosovare që janë Alije Vokshi, Alketa Xhafa Mripa, Arbana Hajredinaj, Rudina Xhaferi, Flaka Haliti, Zake Prelvukaj si dhe me grupin kolektiv HAVEIT. Gjatë kësaj bisede vizuale, veprat e tyre herë pas here janë të kundërta fizikisht, por flasin të njëjtën gjuhë dhe kuptohen shumë mire mes veti. Gjuha vizuale e folur tregon për ndryshimet nga një formë në tjetrën të grave në shoqëri, me një rrëfim të fuqishëm që edhe vetë ndryshon formën.

Lufta e përjetshme mes formës dhe funksionit në të cilën njëra prej tyre mbizotëronte gjatë një periudhe të caktuar kohore, rezultoi me ide të mahnitshme për rëndësinë e secilës prej tyre. Paramendoni format delikate dhe “femërore” të guaskave Rokoko dhe mbajtëset e qirinjve të lakuara dhe me kthesa që vazhdojnë pafundësisht, që i japin shumë rëndësi dekorimit dhe formës. Në kundërshtim me këtë, shekuj më vonë erdhi manifestimi i fuqishëm, mashkullor i logjikës funksionale dhe i industrializmit në art, i quajtur modernizëm.

Gratë ishin dhe deri diku ende janë, të lidhura me formën dhe bukurinë, krahasuar me burrat që ishin personifikime të pastra të funksionit dhe intelektit.

Historikisht, edhe ato iu kanë nënshtruar proceseve të ndryshimeve, ku forma dhe funksioni kanë mbizotëruar me ndërrime. Me aranzhim që i ngjan një beteje, kjo ekspozitë synon të shfaq këto ndërrime mes roleve kur gruaja nuk është vetëm një formë dhe mashkulli nuk është vetëm një funksion.

5. “Piktura e Dorian Gray”, Oscar Wilde, 1890

FORMA

Alije Vokshi, 73 vjeçe, studioi pikturën në Akademinë e Arteve në Beograd dhe pastaj në Paris. Ajo pikturonte portrete të shumta, kryesisht anëtarët e familjes dhe miqtë e saj. Disa nga portretet e saj përshkruajnë bashkëvendësit e saj nga Pobergja, që gjendet afër Deçanit, ku ajo u frymëzua nga një mjedis i bukur natyror dhe nga njerëz krenarë dhe këmbëngulës”. (Prishtina Insight). Vepra e saj “Ina” (1972) është e pikturuar në mënyrën më klasike, me vija të trasha të brushës që shfaqin një padurim për të pikturuar dhe për të përmbushur dëshirën e saj, pavarësisht fëmijëve të vegjël që vrapojnë përreth këmbëve të saj. Gruaja e portretizuar është vjehrra e saj, një figurë shumë e rëndësishme dhe autoritative në shoqërinë kosovare, të cilën Vokshi e respekton, dhe atë jo pse i është imponuar nga shoqëria patriarkale. Këtu shohim një marrëdhënie të thellë personale mes dy grave, ku piktorja thekson karakterin e fortë që vërehet në buzët e shtrënguara të gruas së moshuar dhe nofullën e fortë me një shprehje të mençurisë së lashtë. Karakteri i Inës është formuar gjatë viteve duke punuar me duart e saj të mëdha dhe të forta, të një “Mona Lize” të ulur përballë, shtëpiake, kosovare. Puna e Vokshit, më saktësisht, ajo vetë, thjesht është një pioniere e artit kosovar. Kështu mund ta quajmë edhe Madame Yevonde, me punën e saj novatore në fotografim, duke përdorur një teknikë që atëherë ishte në fazat eksperimentale të quajtur Vivex colour, për të portretizuar gratë, bashkëshortet e personave me autoritet që kishin status të caktuar në shoqëri.

Portretet e saj “Perëndeshat” paraqesin personalitetet e shquara të viteve të 30-ta në mjedise të pazakonta. Ato janë portrete të inskenuara, ndoshta shumë më të ndryshme nga portretet e zakonshme të grave të kohës që synonin të theksonin nënshtrimin, bukurinë dhe feminitetin e tyre. Gratë këtu po kërkonin diçka tjetër, duke luajtur perëndeshat sikur të ishin në një skenë filmike, duke nxjerrë anët e ndryshme të personalitetit të gruas të ilustruar me perëndeshën e

mençurisë dhe luftës (Minerva), muzën e Historisë dhe Europën, një gruan përjetësisht të bukur.

FRAGMENTIMET

Clare Strand me Spice Girls-at e saj shkoi pak më tutje me gratë si modele të diçkaje që është më shumë se vetëm bukuria që ne shohim tek Vokshi dhe Yevonde. Ato paraqesin portrete të pesë vajzave para adoleshente që paraqiten para një sfondi të kuq. Megjithëse e punuar në vitin 1997, vepra e saj merret me tema që duken të përhershme por që janë edhe bashkëkohore, me të cilat shoqëria jonë akoma po merret. Ato janë të rregulluara që të duken të rritura duke imituar pozat e grupit të famshëm të viteve ‘90 me moton”- Girl Power”, dhe në shikim të parë mund të duken simpatike në dëshirën që të duken si idhujt e tyre. Sidoqoftë, shprehjet e tyre të fytyrës dhe mënyra detyruese si qëndrojnë përballë kamerës tregon një histori paksa tragjike. Megjithëse grimi i tyre nuk është grotesk, ai mund të duket i tillë pas një vështrimi më të gjatë të portreteve. Ato nuk duken krenare duke shfaqur pamjen e tyre të Spice-ave, ato ndjehen pakëndshëm nën maskat e tyre të grave të rritura, por megjithatë e durojnë me shpresë që kjo në një farë mënyre t’i bëjë që më në fund të përshtaten në stereotipet e dëshiruara. Ndërsa duke bërë këtë, trupat e tyre shkojnë drejt kamerës duke e ngulftatur atë si një rrugicë e ngushtë ikjeje.

Alketa Xhafa-Mripa shkoi edhe më larg në portretizimin e një modeleje të shqetësuar me Baby Doll On- Baby Doll Off . diptih i dy formave të thjeshta të imponuara nga një shoqëri patriarkale: Me kabllon të futur në prizën e murit për “lëng”, ose të fikur, të çkyqur . Me furi të rrymës, ose pa rrymë. Sido që të jetë, ajo nuk ka identitet pasi që fytyra e kukullës është e mbuluar me thes, në mënyrën më të turpshme për ta trajtuar një grua. Për më tepër, ajo ka të veshura shorce të meshkujve që e shenjëzojnë atë si pronën e pronarit të tyre të vërtetë, një mashkulli. Shorcet e kuqe kanë shenjën e një shqiponjë dykrerëshe, duke i bërë ato simbol

të kombit shqiptar, duke i bërë flamur të kthyer në shorce të meshkujve si një shfaqje e shoqërisë patriarkale. Çuditërisht, gjuha e trupit të gruas së panjohur në këtë vepër arti nuk duket si e thyer apo e pakënaqur. Megjithëse i mbulon gjinjtë, ajo me krenari tregon trupin e saj të bukur, duke shijuar rolin e saj të kukullës deri te një fund i parashikuar, për të cilin artistja po përpiqet të na paralajmërojë: Ashtu siç ishte Strand me Spice Girls, Xhafa gjithashtu duket edhe më vigjilente dhe e shqetësuar për rrezikun e grave që përuken nën presionin e shoqërisë dhe të stereotipeve.

Kontakti personal i fshehur ose i humbur rishfaqet në veprën e Camilla Low, të quajtur “Diva”, ku titulli supozon që ka një prani femërore. Në të vërtetë, një mungesë të pranishme imponuese me një skulpturë duket si një gjerdan i varur në galeri me hijeshi të pazakontë për një objekt të stërzmadhuar.

Untitled(Ann Elliot) nga Abigail Lane, paraqet një palë papuçe me platformë që sugjerojnë një ndërlidhje me kulturën lindore dhe njëkohësisht kujtojnë “nallanet”, papuçe që përdoren në Kosovë nga gratë në punët e tyre të përditshme nëpër oborr. Ato janë të vendosura në një mënyrë të pakujdesshme për të theksuar mungesën e pranishme të gruas që i kishte mbathur, sikur të kishte ikur me nxitim. Në papuçe është një gjurmë këmbë e një kuratoreje, që na sjell në temën e preferuar të Lane-it: gjurmë që duken të freskëta të mbetura si dëshmi të një akti - në këtë rast, një kuratore që na fton të ecim në këpucët e Ann Elliot-it⁶, duke marrë pjesë në këtë veprim. Kështu, Lane në mënyrë transgresive tërheq paralele midis krijimit të artit dhe kryerjes së krimit⁷.

Rachel Whiteread gjithashtu tërhiqet në mënyrë progresive nga mungesa e gjërave. Vepra e saj artistike është rezultat i një talenti shumë të veçantë për të parë dhe lexuar gjërat që nuk janë të dukshme për një sy të zakonshëm, si

6. Ann Elliott ishte një kuratore e ekspozitës në Këshillin Britanik

7. <http://visualarts.britishcouncil.org/collection/search-9/untitled-ann-elliott-lane-1992-p6129/>

hapësira, apo e kundërta e objekteve dhe ndërtesave të ndërtuara nga njeriu. Ajo regjistron dhe formëson ajrin e kapur nën shkallët, brenda mureve dhe brenda objekteve të përditshme. Ajri ose hapësira negative bëhet një skulpturë, si një monument i gjërave të padukshme. Vepra e saj Pa titull (Torso) është një formë brenda një termofori me ujë të nxehtë, një objekt i përditshëm që përdorim për ngrohje. Ajo është formësuar në një masë gipsi dentar me një hijezim që është shumë i ngjashëm me ngjyrën e lëkurës së njeriut, me papërsosmëritë e vogla dhe filluskat e kapura në gips. Titulli nuk e tregon saktë gjininë e Torso-s, megjithatë ngjyra e zbehtë dhe hijeshia e qafës çojnë në një perceptim të një gruaje me një identitet të ngrohtë, por të panjohur, ashtu si Baby Doll e Xhafës.

“Mungesa e pranisë” së një gruaje, duke lënë prapa vetëm veprimet e saj dhe ndikimin e tyre mund të shihet në disa nga veprat në përmbledhjen e Perceptimeve. Laura Aldridge përdor kombinime të tekstileve të ndryshme që varen dekorativisht, poshtë një kolazhi imazhi të ekzagjeruar dhe të redaktuar qëllimisht, në të cilën shohim një gisht që tregon në një mënyrë të papërcaktueshme nëse është një veprim akuzues ose tregon një drejtim - ose ndoshta i bën të dyja; drejt një kolazhi të çuditshëm të perimeve që mund të kenë një kuptim të ndryshëm. Përdorimi i qëndisjes, thurjes dhe zanateve të tjera të lidhura zakonisht me gratë është shumë i zakonshëm, sidomos në mënyrë ironike. Kjo është një teknikë estetike tërheqëse nga e cila gratë artiste shpesh ironizojnë me vepra të artit “tipike femërore”. Anthea Hamilton është një tjetër “Burrneshë” që përdor kolazhet dhe kontrastet tredimensionale për të formuar skulpturat e saj të mëdha. Këmba e karriges (Më vjen keq për vonesë) është një kopje e këmbëve të saj, të përkulura dhe të hapura deri në maksimum. Këmbët të japin një dukje femërore por kërcënuese që mund të ndërliken me procesin e lindjes ose të bërit seks. Transparenca e skulpturës zbulon një tekst dekorativ që pasqyrohet, por që nuk vërehet në shikim të

parë, që thotë “Kërkoj falje për vonesën”. Kjo frazë është gjithashtu titulli i ekspozitës së saj të mbajtur në vitin 2012 ku ajo thotë se këtë frazë e ka përdorur për shkak se “nëse kërkon falje shpesh, atëherë kërkimfalja avullohet ose duket e pasinqertë”⁸.

Helen Chadwick, skulptore, fotografe dhe artiste e instalacioneve ishte e njohur për instalacionet e pazakonta dhe fotografitë e kombinimeve shkencore të gjësendeve të përditshme me elemente organike të lidhura në kompozime komplekse dhe të çuditshme. Puna e saj Adore < Abhor është printuar në shtypshkronjë në orientimin “landscape”, duke i paraqitur fjalët Adore dhe Abhor përballë njëra-tjetrën, për të ngjarë në një reflektim pasqyre të dy kuptimeve të kundërta. Ato madje shkojnë pjerrtas drejt qendrës si dhe njëra-tjetrës. I njëjti konfiguracion përdoret edhe në dekorimet që shkojnë drejt qendrës nga lartë dhe poshtë imazheve kryesore të fjalëve.

Titulli që përmban simbolet matematikore për “Më e madhe se” dhe “Më e vogël se” provokojnë dhe vënë në dyshim rolin e një individi në shoqëri dhe rëndësinë e perceptimit.

NDRYSHIMET

Ndryshime të mëdha kanë ndodhur gjatë jetës sonë dhe në vendin tonë. Ndryshime në politikë, në sistemet ekonomike si dhe ato sociale. Duke qenë të zëna në këto ndryshime, gratë janë përpjekur të bëhen pjesëmarrëse aktive të ndryshimeve drejt shoqërive më të mira dhe kanë arritur ta bëjnë këtë me sukses. Gratë artiste kanë fituar vendin e tyre të merituar në muzetë dhe shkollat e artit. Megjithatë, ato i presin disa ndryshime të mëdha, e të cilat burojnë nga qasja kritike e grave kundër diskriminimit në sistemet ekzistuese. Përdoren forma të ndryshme të kritikës, në disa raste më të drejtpërdrejta se në të tjerat, duke

8. <http://visualarts.britishcouncil.org/collection/artistet/Hamilton-Anthea-1978>

shfaqur shenja se rolet e grave në shoqëri si dhe në art janë duke ndryshuar.

Rudina Xhaferi mund të përkufizohet si artistja më eksperimentale në Kosovë, gjithmonë duke përdorur trupin e saj si pëlhurë, si mjet i performancës dhe si një bazë për kolazhet groteske. Videoja e saj “Nuk dëgjoj asgjë” është pjesë e koleksionit të GKK ku shfaq artisten që i bëhet një intervenim kirurgjik gjatë së cilës po i qepet veshi. Mostra dekorative e qepjes i ngjan një cope të qëndisur për dekorimin e enterierit, të bëra tradicionalisht nga gratë e reja që do të martohen. Titulli tregon se ajo i nënshtrohet procedurës për ta izoluar veten plotësisht nga diskursi që i është imponuar nga shoqëria dhe normat e saj. Veprimet simbolike si ky që kritikojnë sistemet jo aq subtile dhe jo aq femërore, janë rishfaqur në 20 vitet e fundit në mesin e grupit të vogël të artisteve aktive në Kosovë. Arbana Hajredinaj, artiste dhe producente e artit për stacionin televiziv publik, përdor veprime të ngjashme me rituale në punën e saj dhe një nga këto veprime rishfaqet në të tri performanca të saja. Ritualin zhvillohet nga një person që mban një fletë të bardhë të mbështetur mbi fytyrë duke u përpjekur të gjurmojë skajet e fytyrës me një laps. Rezultati nuk është asnjëherë i njëjtë, andaj artistja me këtë vë në pyetje shumë aspekte të shoqërisë sonë dhe perceptimin e saj të individit. Ajo vë në pikëpyetje ngjashmërinë e figurës që kemi për veten tonë dhe atë që shoqëria ka për ne. Videoja «30%» tregon Hajredinajn të ulur në një karrige të rehatshme, e cila është një simbol i statusit për burrat në pozita të larta. Qëndrimi i saj tregon se ajo nuk ndihet rehat në të, pothuajse nuk është vendi i saj për tu ulur aty. Ajo vazhdon me ritualin e gjurmimit të fytyrës së saj në një fletë letre, pa ndërprerë. Titulli i veprës është një koment i përfaqësimit prej 30% të grave në parlamentin e Kosovës⁹.

9. Në Kosovë, që nga zgjedhjet e para kombëtare të mbajtura më 17 nëntor 2001, u aplikuan kuotat e obligueshme rë përfaqësimit të grave prej 30% prej numrit të përgjithshëm. http://www.institutigap.org/documents/31876_Gap%20analiza_perberja%20gjinore%20e%20bordeve.pdf

Ndikimi i grave që tashmë janë në institucione, shpesh shikohet nën llupë dhe kritikohet. Hajredinaj me ironi përfaqëson gratë kosovare me ritualin e saj të gjurmimit, duke përcjellë mesazhin tek të gjithë njerëzit, se përpos të gjitha identiteteve që kanë gratë e Kosovës, përtej gruas që punon, kuzhinieres, amvises, nënës dhe dashnores, ato gjithashtu mund të jenë udhëheqëset tuaja. Natyra e një gruaje është e adaptueshme dhe ndryshon në varësi të nevojës, ajo mund të ndërrojë lëkurën dhe të shkarkojë të gjithë negativitetin në mënyrë që të mbetet e pastër dhe të vazhdojë procesin e zhvendosjes së saj.

